

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 41, paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031, nenit 19 të Statutit të OFK-së nr. 134, datë 04.06.2025, nenit 9, paragrafëve 1, 2, 4 dhe 13, dhe nenit 31 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së nr. 275, datë 30.12.2024 dhe nenit 12 paragrafi 7 të rregullorës mbi punën e organeve kolegjiale të OFK-së nr.271 të datës 30/12/24, në votimin qarkullues më 04.05.2026, nxjerr këtë:

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Nr. 29 Datë 04/05/2026

VENDIM

I. Hapet gara zgjedhore për kandidim për anëtarë të Kuvendit të OFK-së për legjislaturën e katërt, në afatin nga data **04.05.2026 deri më 14.05.2026**.

II. Kandidati për anëtar të Kuvendit të OFK-së duhet të plotësojë këto kushte:

1. Të jetë në listën votuese të certifikuar nga KQZ në njësinë ku kandidon;
2. Të ketë mbështetjen e së paku pesë (5) anëtarëve të njësisë përkatëse;
 - o Një anëtar/e mund të mbështesë vetëm një (1) kandidat/e për Kuvend;
 - o Kandidati/ja nuk mund ta nënshkruajë mbështetjen për kandidaturën e tij/saj;
3. Të mos jetë i/e dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale që lidhen me keqpërdorimin e detyrës zyrtare apo kundër shëndetit publik;
4. Të mos i jetë shqiptuar masa e tërheqjes së licencës për tre (3) apo më shumë vite gjatë pesë (5) viteve të fundit;
5. Të mos jetë anëtar/e i/e KQZ-së apo KNJZ-së.
6. Kandidati për anëtar të Kuvendit të OFK-së nuk mund të ketë ushtruar dy mandate të njëpasnjëshme në Kuvendin e OFK-së.

III. Dokumentet e nevojshme për kandidim janë:

1. Formulari i plotësuar i kandidimit, i cili merret në ueb-faqen zyrtare të OFK-së;
2. Certifikata mbi dënimet penale, e lëshuar përmes platformës e-Kosova;
3. Vërtetimi etik nuk kërkohet, pasi KQZ është njoftuar zyrtarisht se nuk ka masa të tilla të shqiptuara.

IV. Këto kritere të publikohen edhe në formularin e kandidimit për anëtarë të Kuvendit të OFK-së

V. Kandidaturat dorëzohen fizikisht në zyrat e OFK-së, nga data **04 maj deri më 14 maj 2026**, në orarin **08:30 – 15:00**.


VI. Shfuqizohet vendimi nr. 24 i KQZ-së i datës 30/04/2026.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I dërgohet:

- Anëtarëve të OFK-së;
- Sekretariatit të KQZ-së.

petr
Kryetari i KQZ-së
Mr.Ph. Betim Ramadani



Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

OFK - KQZ